



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 60008-00601-00-2023 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2023-1798 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Ilir PANDA	Kryesues
Sokol BINAJ	Anëtar
Sandër SIMONI	Anëtar

Sot, në datë 07.11.2023, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale me nr. 60008-00601-2023 akti, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë

OBEJKT: Caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i Kodit të Procedurës Penale, mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, që i përket Repartit Ushtarak Nr. 2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Kallëzimi i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Ilir Panda dhe diskutoi në dhomë këshillimi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, ka paraqitur në datë 02.02.2022, kërkesën për caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i Kodit të Procedurës Penale mbi territorin si dhe ndërtimet që janë kryer apo janë në kryerje e sipër, që ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr. 2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit rezulton se, më datë 16.03.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me anë të Urdhrit "Për regjistrimin e procedimit penal", ka vendosur regjistrimin e procedimit penal Nr. 205/2021 për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa regjistruar emrin e ndonjë personi nën hetim.

3. Gjithashtu, më datë 23.03.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me anë të Urdhrit "Për regjistrimin e procedimit penal", ka vendosur regjistrimin e procedimit penal Nr. 220/2021 për kryerjen e veprës penale "Ndotja e ujërave", të parashikuar nga neni 203 i Kodit Penal, pa regjistruar emrin e ndonjë personi nën hetim.

4. Me anë të vendimit "Për bashkimin e procedimeve", datë 23.06.2021, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur bashkimi i dy procedimeve të mësipërme, në një procedim të vetëm penal, konkretisht procedimin penal Nr. 205/2021.

5. Ky procedim penal është regjistruar për shkak se më datë 04.03.2021 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë është protokolluar kallëzimi penal i paraqitur nga Komanda e Forcës Detare. Konkretisht, rezulton se ka qenë Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar që ka dërguar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë materialin kallëzues për kompetence lëndore, duke parashtruar se Komanda e Forcës Detare, bazuar në VKM Nr. 515, datë 18.07.2003, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", nëpërmjet shkresës së datës 25.04.2004, "Kërkesë për regjistrimin e pronave të paluajtshme të Ministrisë së Mbrojtjes në administrim të Forcës Detare", ka dërguar dokumentacionin teknik të hartuar nga IGJU dhe ka kërkuar prerjen e faturës së aplikimit për pronat Nr. 974, 975, 976, 977, 978, 979 në prefekturën Lezhë. ZVRPP Lezhë, lidhur me aplikimet e bëra, ka lëshuar në mënyrë të pjesshme vërtetime nga dokumentet hipotekore për disa nga këto prona, ndërsa për pronat e tjera nga pala kallëzuese pretendohet se janë tjetërsuar në kundërshtim me ligjin në drejtim të personave të caktuar. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka çmuar se nga studimi i materialit kallëzues rezulton se nuk ndodhemi përpara pretendimeve për element të ndonjë veprë penale në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie në kuptim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Për këto arsye, është dërguar materiali kallëzues pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë me qëllim që nga kjo e fundit të vlerësohet në lidhje me veprimet e kundërligjshme të punonjësve të ZVRPP Lezhë apo të personave përfitues të këtyre pronave në kundërshtim me ligjin. Nga kallëzimi penal i paraqitur nga Reparti Ushtarak Nr. 2001, përveç sa është cituar më sipër, rezulton se kallëzuesi është institucion shtetëror që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të RSH. Pala kallëzuese, bazuar në VKM Nr. 515/2003, ka aplikuar pranë ZVRPP Lezhë dhe nga kjo e fundit, pas një korrespondence të gjatë në rrugë zyrtare, nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural me qëllim që të regjistrohen pronat në emër të kallëzuesit. Pas aplikimit që është bërë nga ana e palës kallëzuese, ZVRPP Lezhë ka dhënë dokumentacione të pjesshme pronësie individëve të ndryshëm brenda pronës Nr. 974 "Baza ndihmuese" në Shëngjin për sipërfaqen prej 62,738m². Një veprim i tillë është kryer në kundërshtim flagrant me ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, pasi këto dokumente pronësie janë dhënë pas aplikimit që është bërë nga ana e palës kallëzuese si dhe brenda sipërfaqes e cila, në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është brenda planit të përhapjes dhe vendosjes së Forcave të Armatosura në rast të çdo nevojë operationale për mbrojtjen e sovranitetit dhe mos cenimit të sigurisë kombëtare. Brenda pronës e cila është në administrim të palës kallëzuese, i janë dhënë dokumente pronësie subjekteve private, ku ZVRPP Lezhë edhe pas kërkesës që pala kallëzuese ka paraqitur për t'u informuar në lidhje me veprimet e kryera nga ZVRPP Lezhë për lëshimin e dokumenteve të pronësisë së kallëzuesit, nuk ka kthyer përgjigje në rrugë zyrtare. Në këto kushte, Komandanti i Forcës Detare i është drejtuar ZVRPP, e cila, pasi ka

bërë verifikimin përkatës të dokumentacionit ligjor, ka informuar komandën e Forcës Detare se ka urdhëruar ZVRPP Lezhë për marrjen e masave urgjente për dërgim informacioni dhe dokumentacioni. ZVRPP Lezhë i ka bërë me dije palës kallëzuese se nuk mund të regjistrohen pronat në emër të kallëzuesit pasi ato tashmë krijojnë mbivendosje për shkak të figurojnë në emër të subjekteve private.

6. Kallëzuesit kanë pretenduar se nga ana e tyre vazhdimisht janë paraqitur kallëzime penale pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për subjekte të ndryshme private që kanë cenuar territorin në brendësi të pronës që ndodhet në administrimin e kallëzuesit.

7. Prej tyre është pretenduar se Prokuroria ka vendosur pushimin e hetimeve për shkak se subjektet disponojnë leje ndërtimi dhe shfrytëzimi të miratuar nga Bashkia me qëllim ndërtimin e objekteve turistike brenda territorit të bazës ushtarake.

8. Gjatë hetimeve që janë kryer janë administruar të gjitha shkresat e sipërcituara dhe që i përkasin korrespondencës ndërmjet palës kallëzuese dhe ZVRPP Lezhë, etj.

9. Janë administruar dokumentet përkatës që i përkasin lejeve të ndërtimit, etj., që janë dhënë për subjekte të ndryshme nga Bashkia Lezhë për ndërtime që janë kryer në pronën e palës kallëzuese. Shtetasi Denis Madhi ka deklaruar se e ushtron detyrën e juristit pranë komandës së Forcës Detare Durrës dhe se nuk e di arsyen se përse ASHK nuk ka regjistruar pasuritë që sipas VKM Nr. 515/2003 janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, duke qenë se është aplikuar që në vitin 2004 dhe kanë filluar procedurat e regjistrimit për këto pasuri, duke shtuar se edhe pse për pasuritë me Nr. 974 është lëshuar vërtetimi hipotekor, ende nuk janë regjistruar këto pasuri.

10. Ndërkohë, gjatë hetimit të çështjes është verifikuar e ka rezultuar i saktë fakti se: Sipas VKM Nr. 515, datë 18.07.2003, Reparti Ushtarak Nr. 2004 (Flotilja Detare Pashaliman) ka në inventar këto pasuri: Pasuria me Nr. 975, me emërtim ambiente shërbimi, Shëngjin, vendndodhja Shëngjin; Pasuria me Nr. 976, me emërtim ish bateri ABD, Rëra e Hedhur Shëngjin, vendndodhja Shëngjin; Pasuria me Nr. 978, me emërtim ish bateri AKA, Kune, Shëngjin, vendndodhja Shëngjin; Pasuria me Nr. 979, me emërtim ish bateri AKA, Kala, Lezhë, vendndodhja Lezhë; Pasuria me Nr. 1311, me emërtim ish baza ndihmuese, Shëngjin, Lezhë, vendndodhja Lezhë; Pasuria me Nr. 1312, me emërtim baza ndihmuese, Shëngjin, Lezhë, vendndodhja Lezhë; Pasuria me Nr. 1368, me emërtim ish bateri AKA, Kala, Lezhë, vendndodhja Lezhë; Pasuria me Nr. 1369, me emërtim ish bateri AKA, Kala, Lezhë, vendndodhja Lezhë dhe Pasuria me Nr. 1179, me emërtim poligon qitje MD, Shëngjin, Lezhë, vendndodhja Lezhë.

11. Gjithashtu, nga provat e administruara rezulton se ZVRPP Lezhë, më datë 18.11.2014, ka marr vendim për të pezulluar regjistrimin e kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes së datës 08.06.2014 gjer në paraqitjen e një aplikimi të ri që përfshin të gjitha pasuritë që citon VKM Nr. 515/2013, duke argumentuar se duhet të vendoset pezullimi për shkak se aplikimi i paraqitur është shume pjesor dhe nuk përfshin të gjitha pasuritë që përfshin VKM Nr. 515/2003 e si rrjedhojë duhet pezulluar deri kur të paraqitet një shtesë e aplikimit si dhe plan rilevimet për çdo pasuri që ndërhyhet me ndarje ose bashkim për të bërë të mundur regjistrimin e saj.

12. Më datë 05.03.2021 ka paraqitur kallëzim penal shtetasi Artan Pulaj, me detyrë komandant i vendbanimit Shëngjin, reparti ushtarak 2004, duke pretenduar se shoqëria "Flori" sh.p.k., me ndërtimin që po kryen në ambientet që ky repart ka në administrim në bazë të VKM Nr. 220/2017 ka hedhur inerte të ndryshme në bankinë dhe vaskën që përdoret për ankorim dhe gatishmërinë e flotës detare, duke deformuar edhe konturet e bankinës. Ai ka sqaruar edhe se ky territor është pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe është në inventarin e kësaj Ministrie.

13. Është kryer edhe ekspertimi përkatës ku ka rezultuar se sasia e inerteve që është hedhur në vaskën e ujit ka një shtrirje të kufizuar dhe në total mund të eliminohet duke i

zhvendosur inertet nga vaska e ujit. Bazuar në përkufizimet e ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi", eksperti ka vlerësuar se depozitimi i inerteve mund të cilësohet si një "ndotje e vogël" për shkak të shtrirjes dhe sasisë së kufizuar dhe mund të shmanget duke përdorur mjete dhe mundësi vendore.

14. Gjatë hetimeve që po kryhen në kuadër të fakteve të mësipërme, organi i akuzës ka paraqitur kërkesën objekt gjykimi duke pretenduar se ZVRPP Lezhë i ka bërë me dije kallëzuesit se nuk mund t'i regjistrojë këto prona pasi ato tashmë krijojnë mbivendosje sepse figurojnë të regjistruara në emër të subjekteve të ndryshëm privat. Madje këto subjekte janë pajisur me leje ndërtimi dhe shfrytëzimi të objekteve turistike brenda territorit të bazës ushtarake e disa nga këto subjekte po tentohet të kryhen punime, veprime që cenojnë sigurinë kombëtare, duke qenë se këto prona me dekret të Presidentit të RSH janë brenda planit të përhapjes dhe vendosjes së FA.

15. Në nenin 9/2/f të ligjit Nr.64/2014 parashikohet se Presidenti i RSH me propozim të Ministrit të Mbrojtjes miraton planin e vendosjes dhe përhapjes së FA në kohë paqeje.

16. Në nenin 6/1/c të ligjit Nr.9325/2004 është parashikuar se subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi ose përdorim të MM, por që janë jashtë strukturës së FA, të miratuara nga Presidenti i RSH.

17. Në kërkesën e paraqitur, Prokurori ka parashtruar faktin se në rastin konkret rezultojnë që prona në fjalë, në bazë të dekretit të Presidentit të RSH, është brenda përhapjes dhe vendosjes së FA dhe për këtë arsye regjistrimi i kësaj prone në pronësi të subjekteve të ndryshëm privat është në kundërshtim me ligjin dhe përbën edhe cenim të sigurisë kombëtare. Duke marrë në konsideratë faktin se punimet që po kryhen në brendësi të territorit të bazës ushtarake cenojnë sigurinë kombëtare del e domosdoshme vendosja e sekuestros preventive mbi punimet që po kryhen në brendësi të territorit të bazës ushtarake.

Sipas prokurorit, disponimi i lirë i territorit si dhe i ndërtimeve që po kryhen në këtë territor do të zgjasë pasojat e veprës penale, duke marrë në konsideratë faktin se këto punime po kryhen brenda territorit të një bazë ushtarake, disponimi i lirë i sendeve në fjalë do të passjellë kryerjen e ndërtimeve të tjera të kundërligjshme apo përfundimin e atyre ndërtimeve të cilat kanë filluar dhe të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

18. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**, me vendimin penal nr. 70, datë 10.02.2022, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës.
- Vendosjen e masës së sigurimit pasurorë "Sekuestro preventive" mbi pasuritë e paluajtshme që sipas VKM Nr.515/2003 janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe konkretisht të palës kallëzuese Reparti Ushtarak Nr.2001, pjesë e strukturës organizative të Forcave të Armatosura të RSH si dhe ndërtimet që janë kryer apo që janë në ndërtim e sipër mbi këtë territor.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë.
- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 10 ditëve nga marrja dijëni e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijëni për sekuestron e vënë.

18.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: "(...).

13. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 274 të K.Pr.Penale që parashikon se: "1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron." Nga interpretimi i këtij neni rezultojnë se, sekuestroja preventive në bazë të neneve 274-276 të Kodit

të Procedurës Penale urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi, që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj, të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera (Neni 274/1 i K.Pr.Penale). Po ashtu, sekuestroja preventive lejohet edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal (Neni 274/2 i K.Pr.Penale). Sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të parandalimit" të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës "2", të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të sekuestrimit", sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një "goditje" më efektive të avantazheve ekonomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale, masa në fakt merr trajtën e një sanksioni penal. Pra, referuar nenit 274 të K.Pr.Penale që të vendoset sekuestrimi i një sendi me vendim gjykate, duhet të ekzistojë një nga rastet: të ketë rrezik që disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën penale të mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Ky vendim merret me kërkesën e prokurorit, drejtuar gjykatës. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K.Penal.

14. Gjykata vlerëson se në bazë të analizës së mësipërme për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive duhet të plotësohet njëkohësisht dy kushte kumulative që janë:

a) Së pari, prania e indicieve rreth kryerjes (së mundshme në të ardhmen e afërt) të një fakti që përbën vepër penale sipas dispozitave të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rëndimi, apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit penal të dyshuar se është kryer apo do të kryhet. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se janë shkelur dispozitat materiale penale e është kryer të paktën vepra penale e parashikuar nga 248 i K.Penal. Vlerësohet se kjo vepër penale është kryer si nga punonjësit e ish- ZVRPP Lezhë dhe aktualisht ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë, por edhe punonjësit e Bashkisë Lezhë. Ky dyshim provohet nga tërësia e provave të paraqitura në gjykim prej organit të akuzës dhe të cituara në mënyrë të hollësishme nga ana e Gjykatës tek rrethanat e faktit, që tregojnë se me anë të veprimeve apo edhe mosveprimeve që janë kryer nga ish-ZVRPP Lezhë dhe aktualisht ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë është cenuar pronësia mbi pronat që sipas VKM Nr.515/2003 janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe palës kallëzuese, duke qenë se kanë kaluar në pronësi të subjekteve private dhe mbi këtë territor janë ndërtuar dhe po ndërtohen ndërtime të ndryshme, përfshirë ato me natyrë turistike etj. Gjithashtu, është e paqartë arsyeja se përse nga vetë pala kallëzuese janë lejuar këto veprime deri në këto momente.

b) Së dyti, të ekzistojë rreziku që disponimi i lirë i pasurisë të zgjasë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale në të ardhmen. Kështu, zbatimi i masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" duhet të ketë si qëllim shmangien e ardhjes, zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo shmangien e lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Ky kusht nuk duhet vlerësohet në mënyrë abstrakte, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i sekuestros preventive, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera mund të kryhen në të ardhmen. Ky kusht përbën vetë qëllimin për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë. Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se caktimi i masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive është i domosdoshëm në rastin konkret për shkak se, ekziston dyshimi se disponimi i lirë i pasurisë së paluajtshme mund të bëhet shkak për zgjatjen e pasojave të veprës penale ose për lehtësimin e kryerjes së veprave penale të tjera. Një konkluzion i tillë bazohet edhe në faktin

se ende edhe sot vazhdojnë ndërtimet, kalimet e pasurive në pronësi të personave të tretë etj.(...)

19. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Petrika Gollosi dhe Alqi Gollosi, duke kërkuar “Shfuqizimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 “Per caktim mase sigurimi pasurorë” te Gjykatës se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe heqjen e sekuestros mbi pasurinë nr. 820/14-2, vol. 7, fq.57, ZK 2569, me sipërfaqe 2300 m2, lloji i pasurisë "Pyll", me adrese Mali Shëngjin, Lezhë, dhe pasurisë nr. 820/14-1, vol. 7, fq.56, ZK 2569, me sipërfaqe 300 m2, lloji i pasurisë "Truall", me adrese Mali Shëngjin, Lezhë”.

20. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Edmond Prendi, duke kërkuar “Ndryshimin e vendimit numër 70, datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës se Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K.Pr.Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

21. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar shoqëria “Flori” shpk me administrator Florin Mandreu, duke kërkuar “Pranimin e ankimit. Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës se Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K. Pr. Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

22. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Tonin Dodaj, duke kërkuar “Pranimin e ankimit. Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës se Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K.Pr.Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

23. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Mark Bajraktari, duke kërkuar “Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës se Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K. Pr. Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

24. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Zef Kolaj, duke kërkuar “Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës se Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K.Pr.Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

25. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Ilir Elezi dhe Ajet Elezi, duke kërkuar *“Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K.Pr.Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*.

26. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Saimir Mergjyli dhe Aida Mergjyli, Mark Bajraktari, duke kërkuar *“Shfuqizimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe heqjen e sekuestros mbi pasurinë nr.1013/3, vol.8, fq.189, ZK2569, me sipërfaqe 1000m2, lloji i pasurisë “Pyll” me adresë Mali Shëngjin, Lezhë”*.

27. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Erion Brunga, duke kërkuar *“Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K.Pr.Penale mbi territorin si dhe ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*.

28. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Nik Palokaj, duke kërkuar *“-Ndryshimin e vendimit nr.70, datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në lidhje me vënien e masës së sigurimit të “Sekuestros preventive” mbi dy pronat e mia dhe konkretisht pronat me nr.pas.930/14,2K nr.2569,vol.5,faqe 199,adresa e pasurisë Lezhë, Mali Shëngjin, lloji i pasurisë pyll, sipërfaqja totale 1158 m2, e regjistruar me datë 06.12.2005 në emër të Nik Mark Paloka, dhe pasurisë me nr.932/3,ZK nr.2569, vol.4, faqe 179, adresa e pasurisë Lezhë, Mali Shëngjinit, lloji i pasurisë pyll, sipërfaqja totale 938 m2, e regjistruar në emër të Nik Mark Paloka më datë 05.06.2018. Heqjen e masës së sigurimit të “Sekuestros preventive” përse i përket këtyre dy pronave”*.

29. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Pashko Curi, Gjek Curi dhe Frajdi Curi, duke kërkuar *“Pranimin e ankimit. Ndryshimin e vendimit nr. 70 të datës 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë duke vendosur rrëzimin e kërkesës për masën e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për pasuritë me nr.820/33 Zona kadastrale 2569, vol.6faqe 105, me nr.930/24 zona kadastrale 2569, vol.10, faqe 74 dhe me nr.930/23, zona kadastrale nr.2569, vol.10, faqe 75.”*.

30. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Ndoc Margjonaj, Leze Grishaj, Engjell Grishaj dhe Nikoll Dodaj, duke kërkuar *“-Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Rrëzimin e kërkesës duke hequr sekuestrot preventive për pronat e tyre”*.

31. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Artur Palokaj, duke kërkuar *“Të heqë masën e sekuestros preventive për pronat që unë disponoj.”*

32. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Valentina Prela duke kërkuar *“Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për Caktimin e masës së sigurimit pasurorë “sekuestro preventive”, parashikuar nga neni 274/1 i K.Pr.Penale mbi territorin si dhe*

ndërtimet të cilat janë kryer apo janë në kryerje e sipër, të cilat ndodhen brenda këtij territori, i cili i përket Repartit Ushtarak Nr.2001, që bën pjesë në strukturën organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.”

33. Ndaj vendimit me nr. 70, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, ka ushtruar ankim, personi i interesuar Simon Ivanaj duke kërkuar “Ndryshimin e vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë përsa i përketë sekuestros preventive vënë nga ana e DVASHK Lezhë mbi pasurinë nr.820/44, vol.10, faqe 84, zona kadastrale 2569, Mali Shëngjin Lezhë.”

34. **Gjykata e Apelit Shkodër**, me vendimin nr. 111, datë 30.04.2022, ka vendosur:

- Miratimin e vendimit numër 70, datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit arsyetuar

34.1 Gjykata e apelit, në përgjigje të shkaqeve të parashtruara në ankim, ka argumentuar se: “(...) **27.Pas analizës së dispozitave ligjore mbi sekuestron, pas analizës së vendimit numër 201, datë 09.12.2015 të Gjykatës së Lartë, pas analizës së shkakut për të cilin është vendosur kjo masë sigurimi pasurore ,Gjykata e Apelit arrin ne konkluzionet se:**

a. Masa e sigurimit pasurore “Sekuestro preventive” është vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesë te Prokurorisë se Rrethit Lezhë, duke u plotësuar kështu kushti i parashikuar ne nenin 274/1 i Kodit te Procedurës Penale.

b. Vendimi për caktimin e masës se sigurimit pasurore “Sekuestro preventive”, është marrë e shpallë nga Gjykata e shkalles se parë brenda afatit të caktuar e ligj, duke u plotësuar kështu kushti i parashikuar nga neni 276/7 i Kodit te Procedurës Penale.

c. Nga provat e paraqitura, edhe Gjykata e Apelit krijon bindjen se ekziston një dyshim i arsyeshëm e i bazuar ne prova se nga punonjësit e ish-ZVRPP Lezhë(aktualisht ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë) por edhe punonjësit e Bashkisë Lezhë mund te jenë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 e 25 te Kodit Penal.

Këto dyshime provohen nga tërësia e provave te paraqitura ne gjykim prej organit te akuzës dhe te cituara ne mënyrë te hollësishme nga ana e Gjykatës tek rrethanat e faktit, qe tregojnë se me ane te veprimeve apo edhe mosveprimeve qe janë kryer nga ish-ZVRPP Lezhë dhe aktualisht ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë është cenuar pronësia mbi pronat qe sipas VKM Nr.515/2003 janë ne administrim te Ministrisë se Mbrojtjes dhe palës kallëzuese, duke qene se kane kaluar ne pronësi te subjekteve private dhe mbi këtë territor janë ndërtuar dhe po ndërtohen ndërtime te ndryshme, përfshirë ato me natyre turistike etj.

d. Për faktet e kallëzuara nga Komanda e Forcës Detare te Republikës se Shqipërisë më datë 23.06.2021 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë është regjistruar procedimi penal numër 205 i vitit 2021 për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “Ndotja e ujërave” parashikuar nga neni 203 i Kodit Penal.

e. Nga te dhënat e këtij procedimi penal edhe Gjykata e Apelit vlerëson se ekzistojnë dyshime te arsyeshme e te bazuara ne prova se pasuritë për të cilat është vendosur sekuestroja preventive mund te rëndojnë, mund te zgjasin pasojat e veprës penale, mund te lehtësojnë kryerjen e veprave e tjera. Këto dyshime te arsyeshme bazohen ne provat e trajtuara hollësisht me lart, ne piken numër 1 te këtij vendimi.

Zbatimi i masës se sigurimit pasurore "Sekuestro preventive" duhet te këtë si qellim shmangien e ardhjes, zgjatjes se pasojave nga vepra penale apo shmangien e lehtësimit te kryerjes se veprave te tjera penale. Ky kusht nuk duhet vlerësohet ne mënyrë abstrakte, por si një probabilitet realist, qe sendi objekt i sekuestros preventive, te behet shkak rendues,

zgjatës, për veprën penale te supozuar, apo shkak lehtësues për vepra te tjera mund te kryhen ne te ardhmen. Ky kusht përbën vete qëllimin për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë.

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesa e Prokurorit, që te caktohet masa e sigurimit pasurorë e "Sekuestro preventive", është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe në prova.

f. Vërtetohet prania e elementit "veprime ne kundërshtim me ligjin e ne mos përmbushje te rregullt te detyrës nga ana e punonjësit qe kryen një detyre shtetërore" në këtë rast nga ana e nga punonjësve te ish-ZVRPP Lezhë(aktualisht ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë) dhe punonjësve te Bashkisë Lezhë dhe se sendi (pasuritë e paluajtshme) përbejnë produktin e veprës penale.

g. Vërtetohet ekzistenca e lidhjes se posaçme, funksionale, jo te rastësishme dhe e qëndrueshme midis sendit dhe veprimit penal te kundërligjshëm.

h. Caktimi i masës se sigurimit pasurorë sekuestro preventive është i domosdoshëm ne rastin konkret për shkak se, ekziston dyshimi se disponimi i lire i pasurisë se paluajtshme mund te behet shkak për zgjatjen e pasojave te veprës penale ose për lehtësimin e kryerjes se veprave penale te tjera. Një konkluzion i tille bazohet edhe ne faktin se ende edhe sot vazhdojnë ndërtimet, kalimet e pasurive ne pronësi te personave te trete etj.

Bazuar ne analizën e fakteve e provave, bazuar ne ligjin penal(neni 36 i Kodit Penal),bazuar ne ligjin procedural penal(nenet 210 e 274 te Kodit te Procedurës Penale),Gjykata e Apelit vlerëson se me te drejte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendose qe te pranoje kërkesën e paraqitur nga Prokurori dhe ka vendose masën e sigurimit pasurorë "Sekuestro preventive" mbi pasuritë e paluajtshme qe sipas VKM Nr.515/2003 janë ne administrim to Ministrisë se Mbrojtjes dhe konkretisht te palës kallëzuese Reparti Ushtarak Nr.2001,pjese e strukturës organizative to Forcave te Armatosura të RSH si dhe ndërtimet qe janë kryer apo qe janë ne ndërtim e sipër mbi kete territor.

Me te drejte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka çmuar se me anë të kërkesës objekt gjykimi organi procedues, ka arrite te vërtetojë se ekziston dyshimi apo ka arsye të bazuara për të dyshuar se pasuritë kane lidhje me veprat penale për te cilat është regjistruar procedimi penal ne Prokurorinë e Rrethit Lezhë.. (...)."

35. Kundër vendimit nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit, Shkodër, ka paraqitur rekurs, më datë 17.07.2023, personi i interesuar Nik Palokaj, i cili ka marrë dijani për vendimin e arsyetuar në datë 14.06.2023, me të cilin ka kërkuar: ndryshimin e vendimeve nr.111, datë 30.04.2022, i cili ka miratuar vendimin nr.70, datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes duke vendosur: heqjen e masës së sigurimit të "sekuestros preventive", përse i përket pronave të regjistruara në emër tim. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:

- Pronën e kam fituar në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993, të cilën e kam regjistruar më pas dhe jam pajisur me certifikatë pronësie.
- Pala kallëzuese me vendimin të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, është rrëzuar pretendimi i saj për rishikimin e vendimit civil me nr.298, datë 05.09.2003. Në bazë të këtij vendimi pronat e mia janë regjistruar më parë se sa pronat e kallëzuesit, madje kam edhe të drejtën e parablerjes së objekteve në rast të privatizimi, si ish-pronar i tokës në të cilën ndodhen objektet
- Sipas kërkesës sime nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik më është konfirmuar se pasuria me nr.974/1 bën pjesë në listën e pronave që nuk do të mbeten në përdorim të FA të RSH dhe si e tillë do të privatizohen.
- Gjykata e Apelit nuk mori në konsideratë pretendimet që sekuestroja është marr në kundërshtim me dispozitat e nenit 274 të KPP, pasi në rastin konkret prej meje nuk ka asnjë vepër penale dhe kjo pronë është përfituar në mënyrë të ligjshme. Por edhe sikur të jemi përpara shpërdorimit të detyrës, nga momenti i regjistrimit në vitin 2010 deri

në momentin e kallëzimit në vitin 2021, në referim të nenit 66të KP, vepra penale e dyshuar si e konsumuar nga nëpunësit e ZVRPP Lezhë është parashkuar.

- Në lidhje me pronat në të cilat janë kryer ndërtime të ligjshme në referim të lejeve të ndërtimit, tregon se ato nuk janë të paligjshme por në referim të akteve zyrtare.
- Pala kallëzuese ka gjetur rrugën e gabuar për të marr pronat e saj, pasi ajo duhet të drejtohej civilisht gjykatës duke kundërshtuar vendimin gjyqësor e cila ka kryer kthimin fizik të pronave.

36. Kundër vendimit nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs, më datë 27.07.2023, personi i interesuar Saimir Mergjyli dhe Aida Mergjyli, i cili ka marr dijani për vendimin e arsyetuar në datë 15.06.2023, me të cilin ka kërkuar: *Ndryshimin e Vendimit Penal (Miratim sekuestro preventive) Nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 date 10.02.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Lezhe dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për caktim mase sigurimi pasuror (për vendosjen e sekuestros) për pasurinë nr. 1013/3, vol. 8, fq.189, ZK 2569, me sipërfaqe 1000 m2, lloji i pasurisë "Pyll", me adrese Mali Shëngjin, Lezhe ose prishjen e Vendimit Penal (Miratim sekuestro preventive) Nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 date 10.02.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë.* Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:

- Së pari në marrjen e vendimeve objekt rekursi gjykata nuk kane respektuar kushtet e përcaktuara në neni 274 të KPP. Për vendosjen e sekuestros duhet te plotësohen këto kushte: - Prania e indiceve rreth kryerjes se mundshme ne te ardhme te afërt te një fakti qe përbën vepër penale sipas dispozitave te Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rendimi apo zgjatjeje te pasojës se veprës penale, apo te një lehtësimi te kryerjes se veprave penale, ne raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret te supozuar se është kryer apo do te kryhet. -Gjykata duhet te verifikojë dhe argumentojë praninë e indiceve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do te arrihet një vendim dënimi.- Ekzistenca e rrezikut se disponimi i lire i pasurisë se paluajtshme do te zgjasë pasojat e veprës penale, ose do te lehtësojë kryerjen e veprave penale ne te ardhmen. - Sendi duhet të këtë shërbyer apo është i destinuar për kryerjen e veprës penale.- Duhet të vërtetohet lidhja midis sendit dhe veprimit penal. - Sekuestrimit nuk mund t'i nënshtrohen personat ndaj të cilëve nuk ka dyshime apo gjenden jashtë rrethanave te kryerjes se veprës penale.
- Ne rastin konkret rezulton se nuk ka procedim penal te nisur jo vetëm ndaj ankuesve Saimir Mergjyli dhe Aida Mergjyli por as ndaj ndonjë personi tjetër, apo te ekzistojë dyshim i arsyeshëm i mbështetur ne prova për kryerjen e ndonjë vepre penale. Prona qe posedojnë ankuesit është fituar me mirëbesim dhe ne mënyrë te prejardhur dhe konkretisht me kontrate shitblerje me nr. 5341 rep. nr. 3368 kol datë 13.12.2013 nga Ajet Elezi dhe Ilir Elezi të cilët këtë prone e kane fituar po me mirëbesim me kontrata shitblerje nga Pashke Palokaj etj. Këta të fundit pronësinë e kanë përfituar me Vendimin nr. 148 date 18.04.1996 te KKKP Lezhe, vendim i cili është ndryshuar me vendimin nr.298 date 05.09.2003 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, Lezhë, vendim i cili ka marre forme te prere me date 10.10.2003 (Vendimet e sipërcituara janë pjese e fashikullit te dosjes gjyqësore).
- Referuar sa me sipër parashtruam pasuria nr. 1013/3, vol. 8, faqe 189, ZK 2569, me sipërfaqe 1000 m2, lloji i pasurisë "Pyll", me adresë Mali Shengjin, Lezhë, në pronësi te ankuesve nuk rezulton qe te jete produkt i veprës penale dhe as krijon ndonjë mundësi për kryerjen e ndonjë vepre penale apo shtim te veprave penale te tjera.
- Se dyti: Ne kushtet kur bashkangjitur VKM nr. 515 date 18.07.2003 nuk gjendet asnjë plan rilevimi e pasurisë që ka kaluar ne administrim te Ministrisë se Mbrojtjes,

prokuroria përpara se te kërkonte vendosjen e sekuestros preventive dhe gjykata përpara se te kishte vendosur për një gjë të tille duhet te kishin caktuar një ekspert topograf për të bërë një akt ekspertimi për te përcaktuar pasuritë pjese përbërëse te pasurive te kaluara ne administrim te Ministrisë se Mbrojtjes dhe plan rilevimit përkatës.

- Se treti: Prokuroria nuk ka hetuar fare për origjinën e pronës, po kështu dhe gjykata nuk e ka bërë një hetim te tille pavarësisht se i kane patur mundësitë për ta bërë një gjë të tille. Nga i gjithë dokumentacioni i ndodhur ne dosjen gjyqësore jo vetëm nuk rezulton se prona e ankuesve nuk ka kaluar në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes jo vetëm me VKM nr. 515 date 18.07.2003 dhe VKM te cilat kane disponuar me ndryshimin e këtij vendimi, por as vete pala kallëzuese nuk e ka kërkuar regjistrimin e kësaj pasurie ne favor te sajë.

37. Kundër vendimit nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs, më datë 27.07.2023, personi i interesuar Petrika Gollosi dhe Alqi Gollosi, i cili ka marr dijeni për vendimin e arsyetuar në datë 15.06.2023, me të cilin ka kërkuar: *Ndryshimin e Vendimit Penal (Miratim sekuestro preventive) Nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 date 10.02.2022 te Gjykatës se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqësor Lezhe dhe rrëzimin e kërkesës se prokurorisë për caktim mase sigurimi pasuror (për vendosjen e sekuestros) për pasurinë nr. 1013/3, vol. 8, fq.189, ZK 2569, me sipërfaqe 1000 m2, lloji i pasurisë "Pyll", me adresë Mali Shëngjin, Lezhe ose prishjen e Vendimit Penal (Miratim sekuestro preventive) Nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 date 10.02.2022 të Gjykatës së Shkalles së Parë Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe (të njëjta me rekursin e Saimir dhe Aida Mergjyli) :*

- Së pari në marrjen e vendimeve objekt rekursi gjykata nuk kane respektuar kushtet e përcaktuara në neni 274 të KPP. Për vendosjen e sekuestros duhet te plotësohen këto kushte: - Prania e indicieve rreth kryerjes se mundshme ne te ardhme te afërt te një fakti qe përbën veprë penale sipas dispozitave te Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rendimi apo zgjatjeje te pasojës se veprës penale, apo te një lehtësimi te kryerjes se veprave penale, ne raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret te supozuar se është kryer apo do te kryhet. -Gjykata duhet te verifikojë dhe argumentojë praninë e indicieve qe krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do te arrihet një vendim dënimi.- Ekzistenca e rrezikut se disponimi i lire i pasurisë se paluajtshme do te zgjasë pasojat e veprës penale, ose do te lehtësojë kryerjen e veprave penale ne te ardhmen. - Sëndi duhet te këtë shërbyer apo është i destinuar për kryerjen e veprës penale.- Duhet te vërtetohet lidhja midis sendit dhe veprimit penal. - Sekuestrimit nuk mund ti nënshtrohen personat ndaj të cilëve nuk ka dyshime apo gjenden jashtë rrethanave te kryerjes se veprës penale.
- Në rastin konkret rezulton se nuk ka procedim penal te nisur jo vetëm ndaj ankuesve por as ndaj ndonjë personi tjetër, apo te ekzistojë dyshim i arsyeshëm i mbështetur ne prova për kryerjen e ndonjë veprë penale. Prona qe posedojnë ankuesit është fituar me mirëbesim dhe ne mënyre te prejardhur dhe konkretisht me kontrate shitblerje me nr. 5341 rep. nr. 3368 kol datë 13.12.2013 nga Ajet Elezi dhe Ilir Elezi të cilët këtë prone e kane fituar po me mirëbesim me kontrata shitblerje nga Pashke Palokaj etj. Këta te fundit pronësinë e kanë përfitur me Vendimin nr. 148 date 18.04.1996 te KKKP Lezhe, vendim i cili është ndryshuar me vendimin nr.298 date 05.09.2003 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Lezhe vendim i cili ka marre forme te prere me date 10.10.2003 (Vendimet e sipërcituara janë pjesë e fashikullit te dosjes gjyqësore).

- Referuar sa me sipër parashtroam pasuria nr. 1013/3, vol. 8, faqe 189, ZK 2569, me sipërfaqe 1000 m², lloji i pasurisë "Pyll", me adrese Mali Shengjin, Lezhe në pronësi të ankuesve nuk rezulton që të jetë produkt i veprës penale dhe as krijon ndonjë mundësi për kryerjen e ndonjë veprë penale apo shtim të veprave penale të tjera.
- Se dyti: Në kushtet kur bashkangjitur VKM nr. 515 datë 18.07.2003 nuk gjendet asnjë plan rilevimi e pasurisë që ka kaluar në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, prokuroria përpara se të kërkonte vendosjen e sekuestros preventive dhe gjykata përpara se të kishte vendosur për një gjë të tillë duhet të kishin caktuar një ekspert topograf për të bërë një akt ekspertimi për të përcaktuar pasuritë pjesë përbërëse të pasurive të kaluara në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe plan rilevimit përkatës.
- Se treti: Prokuroria nuk ka hetuar fare për origjinën e pronës, po kështu dhe gjykata nuk e ka bërë një hetim të tillë pavarësisht se i kanë patur mundësitë për ta bërë një gjë të tillë. Nga i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore jo vetëm nuk rezulton se prona e ankuesve nuk ka kaluar në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes jo vetëm me VKM nr. 515 datë 18.07.2003 dhe VKM të cilat kanë disponuar me ndryshimin e këtij vendimi, por as vete pala kallëzuese nuk e ka kërkuar regjistrimin e kësaj pasurie në favor të sajë.

38. Kundër vendimit nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs, më datë 27.07.2023, personi i interesuar Artur Palokaj, i cili ka marrë dënimin për vendimin e arsyetuar në datë 14.06.2023, me të cilin ka kërkuar: Ndryshimin e Vendimit Penal (Miratim sekuestro preventive) Nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Shkalles së Parë të Rrethit Gjyqësor Lezhe dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për caktim mase sigurimi pasuror (për vendosjen e sekuestros) për pasurinë Nr. 820/36 zk 2569 prej 300 m² Trull dhe 155.5 m² Ndërtesë dhe pasuria me Nr. 820/35 zk 2569 prej 500m² Pyll. Te dy pronat e mia ndodhen të hipotekuara për llogari të bankave, pasi e kam vënë si kolateral për kreditë që kam marrë, bashkangjitur gjeni kopje të kartelave. ose prishjen e Vendimit Penal (Miratim sekuestro preventive) Nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Shkalles së Parë të Rrethit Gjyqësor Lezhe dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë paraqitur këto shkaqe:

- Së pari në marrjen e vendimeve objekt rekursi gjykata nuk kanë respektuar kushtet e përcaktuara në neni 274 të KPP. Për vendosjen e sekuestros duhet të plotësohen këto kushte: - Prania e indiceve rreth kryerjes së mundshme në të ardhme të afërt të një fakti që përbën veprë penale sipas dispozitave të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rendimi apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësimi të kryerjes së veprave penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret të supozuar se është kryer apo do të kryhet. -Gjykata duhet të verifikojë dhe argumentojë praninë e indiceve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do të arrihet një vendim dënimi.- Ekzistenca e rrezikut të disponimit të lirë të pasurisë së paluajtshme do të zgjasë pasojat e veprës penale, ose do të lehtësojë kryerjen e veprave penale në të ardhmen. - Së dyti duhet të kërket shërbimet apo është i destinuar për kryerjen e veprës penale.- Duhet të vërtetohet lidhja midis sendit dhe veprimit penal. - Sekuestrimit nuk mund t'i nënshtrohen personat ndaj të cilëve nuk ka dyshime apo gjenden jashtë rrethanave të kryerjes së veprës penale.
- Në rastin konkret rezultoi se nuk ka procedim penal të nisur jo vetëm ndaj ankuesit Artur Paloka, por as ndaj ndonjë personi tjetër, apo të ekzistojë dyshim i arsyeshëm i mbështetur në prova për kryerjen e ndonjë veprë penale.

- Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhe nuk është thirrur dhe as kërkuar asnjëherë mbi pasurinë e tij, e që ndodhet brenda kësaj harte të repartit Ushtarak, pasi rezultoi se Prokuroria e ka në hetim që nga data 16.03.2021.
- Origjina e pronës time vjen nga një Vendim Gjykatë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhe me Nr. 228 datë 20.09.2000.
- 4. Mbi pasurinë e përmendur më lart kam ndërtuar një shtëpi banimi me leje ndërtimi lëshuar nga Ish-Komuna Shëngjin (bashkangjitur gjëni lejen e ndërtimit) dhe me pas është regjistruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Lezhe (ish ZVRPP Lezhe), ku pas regjistrimit prona ime u nda në dy pjesë, pasuria me Nr. 820/36 zk 2569 prej 300 m² Truall dhe 155.5 m² Ndërtesë dhe pasuria me Nr. 820/35 zk 2569 prej 500m² Pyll. Te dy pronat e mia ndodhen të hipotekuara për llogari të bankave, pasi e kam vene si kolateral për kredite që kam marrë, bashkangjitur gjëni kopje të kartelave.
- 5. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhe që u ka kthyer pronën është marrë Trashëgimtarëve të të ndjerit Gjek Uç Vuksani, vendim që është marrë me datë 20.09.2000, i cili është regjistruar pranë ZVRPP Lezhe, është vendim që me përpara VKM 515/2003. Në bazë të Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 515 i vitit 2003, Ministria e Mbrojtjes duhet të aplikonte dhe të regjistronte pronën pranë ZVRPP, gjë e cila ska ndodhur. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 515/2003 që nga koha që ka dale e deri sot ka pësuar disa ndryshime si në përmbajtje ashtu dhe hartografik.
- Bëjmë me dije Gjykatën se megjithëse nga momenti i regjistrimit të procedimit penal e deri në momentin e rekursit kanë kaluar më shumë se dy vjet prokuroria asnjëherë nuk ka thirrur rekursuesin për ta pyetur për ndonjë hetim penal. Ky fakt veç të tjerave mohon ekzistencën e rrezikut të disponimit të lirë të pasurisë së paluajtshme do të zgjasë pasojat e veprës penale, ose do të lehtësojë kryerjen e veprave penale në të ardhmen. Po kështu nga informacioni që kemi deri në këtë moment nuk rezultoi që nga ana e prokurorisë të jete regjistruar emri i ndonjë punonjësi të Bashkisë apo të Kadastrës (Ish ZRPP-se) në regjistrin e personave që ju atribuohet vepra penale.
- Se dyti: Në kushtet kur bashkangjitur VKM nr. 515 datë 18.07.2003 nuk gjendet asnjë plan rilevimi të pasurisë që ka kaluar në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, prokuroria përpara se të kërkonte vendosjen e sekuestros preventive dhe Gjykata përpara se të kishte vendosur për një gjë të tilla duhet të kishin caktuar një ekspert topograf për të bërë një akt ekspertimi për të përcaktuar pasuritë pjesë përbërëse të pasurive të kaluara në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe plan rilevimit përkatës.
- Se treti: Prokuroria nuk ka hetuar fare për origjinën e pronës, po kështu dhe Gjykata nuk e ka bërë një hetim të tilla pavarësisht se i kanë patur mundësitë për ta bërë një gjë të tilla. Nga i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore jo vetëm nuk rezultoi se prona e ankuesit nuk ka kaluar në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes jo vetëm me VKM nr. 515 datë 18.07.2003 dhe VKM të cilat kanë disponuar me ndryshimin e këtij vendimi, por as vete pala kallëzuese nuk e ka kërkuar regjistrimin e kësaj pasurie në favor të sajë.

39. Kundër vendimit nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit, Shkodër, ka paraqitur rekurs, më datë 31.07.2023, personi i interesuar shoqëria "Flori" shpk, e cila ka marrë dënimin për vendimin e arsyetuar në datë 14.06.2023, me të cilin ka kërkuar: Pranimin e rekursit, prishjen e vendimit nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pushimin e çështjes. Në alternativë kërkojmë nga Gjykata e Lartë që të vendosë prishjen e vendimit nr.111, datë 30.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjyqësor.. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:

- 1. Vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat, vendim tërësisht i gabuar, i njëanshëm e i bazuar mbi interpretim të kushteve e rrethanave të relatuara nga Prokuroria dhe jo mbi provat e administruara në fashikullin e gjykimit. Gjykata e Apelit ka mbajtur një qëndrim tërësisht të njëanshëm duke rënduar pozitën e pronarit të sendit të sekuestruar pa qenë person në hetim.
- 2. Gjykata ka gabuar në vendimmarrjen e saj pasi pa bërë një analizë të detajuar dhe të gjithanshme të kërkesës së prokurorisë, legjislacionit dhe provave të administruara në rastin konkret, ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se është kryer një veprë penale që ka lidhje me këtë pasuri, ka pranuar në mënyrë automatike kërkesën e organit të akuzës për vendosjen e sekuestros preventive pasuritë e paluajtshme që sipas VKM Nr.515/2003 janë në ndërtim në mbi pasuritë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe konkretisht të palës kallëzuese Reparti Ushtarak nr. 2001, pjesë e strukturës organizative të Forcave të Armatosura të R.Sh si dhe ndërtimet që janë kryer apo që janë në ndërtim e sipër mbi këtë territor.
- 3. Vendimmarrja e gjykatës madje është në një format të pamundshëm edhe për tu ekzekutuar nga institucionet e ngarkuara me ligj, pasi sa kohë provohet se në pjesën arsyetuese të vendimit është cenuar edhe pronësia private e ankimuesit Flori Shpk që po ndërton mbi pronën e tij që i është blerë pikërisht shtetasit (pronarit të ligjshëm) z. Rrok Dodaj dhe Marta Dodaj, prona e të cilëve nuk është dhe nuk mund të jetë në administrim të Ministrisë së mbrojtjes, pa u zhveshur më parë nga të drejtat pronësore me një proces të rregullt ligjor.
- 4. Gjykata e Apelit nuk ka mbajtur në konsideratë kuptimin e sekuestros preventive e gjejmë të analizuar edhe në praktikën gjyqësore, veçanërisht atë të Gjykatës së Lartë, ku tërheq vëmendjen një vendim i Kolegjit Penal të kësaj gjykate, nr. 201, datë 09.12.2015 (i vendosur në tërësinë e tij edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë por i pa analizuar në raport me rrethanat konkrete).
- 5. Gjykata e Apelit ka gabuar duke mos vlerësuar se në rastin konkret ashtu si edhe rezultojnë nga të gjitha aktet e dosjes së gjykimit, ndaj personit të interesuar Shoqëria "Flori" Shpk nuk ka asnjë procedim penal të regjistruar (provohet se nuk ka emër të regjistruar për këtë shoqëria po për administratorin') apo ndonjë dyshim tjetër të arsyeshëm se ai ka kryer ndonjë veprë penale që lidhet me ndërtimin që po kryhet, apo se ky ndërtim është produkt i ndonjë veprë penale. Gjithashtu rezultojnë se edhe pasuria konkrete e cila është vendosur nga gjykata nën sekuestro preventive, nuk rezultojnë të jetë produkt i mundshëm i ndonjë veprë penale, dhe as krijon mundësi për vepra të mundshme apo shtim të pasojave të veprave penale të tjera. Është e vërtetë që prokuroria për të qenë në kushtet ligjore të vendosjes së një sekuestro preventive, me Urdhërin e saj të datës 16.03.2021, ka regjistruar procedimin penal 205/2021 të vitit për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", por pa regjistruar emër personi në hetim dhe pa specifikuar se pse kjo veprë e mundshme penale ka lidhje me pasurinë e sekuestruar, dhe pse vendosja e kësaj sekuestro preventive në rastin konkret ishte e domosdoshme.
- 6. Për më tepër, edhe sikur të pranojmë në mënyrë të supozuar se do të kishim indicie apo dyshim të arsyeshëm të ekzistencës së veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal (dyshimi për kryerjen e së cilës është tejet i zbehtë për të mos thënë inekzistent, arsyetuar edhe më poshtë), sërish kryerja e kësaj veprë nuk ka një lidhje të posaçme, funksionale dhe të qëndrueshme me sendin i cili i përket personit të interesuar dhe jo personit të supozuar që do të regjistrojë prokuroria si person nën hetim.

40. **Kundër vendimit nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit, Shkodër, ka**

paraqitur rekurs, më datë 31.07.2023, personi i interesuar shoqëria Tonin Dodaj, i cili ka marrë dijeni për vendimin e arsyetuar në datë 14.06.2023, me të cilin ka kërkuar: *Pranimin e rekursit, prishjen e vendimit nr. 111 datë, 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr.70 datë 10.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pushimin e çështjes. Në alternativë kërkojmë nga Gjykata e Lartë që të vendosë prishjen e vendimit nr.111, datë 30.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykuese.. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe(të njëjta me ato të shoqërisë Flori shpk):*

- 1. Vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat, vendim tërësisht i gabuar, i njëanshëm e i bazuar mbi interpretim të kushteve e rrethanave të relatuara nga Prokuroria dhe jo mbi provat e administruara në fashikullin e gjykimit. Gjykata e Apelit ka mbajtur një qëndrim tërësisht të njëanshëm duke rënduar pozitën e pronarit të sendit të sekuestruar pa qenë person në hetim.
- 2. Gjykata ka gabuar në vendimmarrjen e saj pasi pa bërë një analizë të detajuar dhe të gjithanshme të kërkesës së prokurorisë, legjislacionit dhe provave të administruara në rastin konkret, ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se është kryer një veprë penale që ka lidhje me këtë pasuri, ka pranuar në mënyrë automatike kërkesën e organit të akuzës për vendosjen e sekuestros preventive pasuritë e paluajtshme që sipas VKM Nr.515/2003 janë në ndërtim në mbi pasuritë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe konkretisht të palës kallëzuese Reparti Ushtarak nr. 2001, pjesë e strukturës organizative të Forcave të Armatosura të R.Sh si dhe ndërtimet që janë kryer apo që janë në ndërtim e sipër mbi këtë territor.
- 3. Vendimmarrja e gjykatës madje është në një format të pamundshëm edhe për tu ekzekutuar nga institucionet e ngarkuara me ligj, pasi sa kohë provohet se në pjesën arsyetuese të vendimit është cenuar edhe pronësia private e ankimesit Tonin Dodaj që ka ndërtuar shume vite më parë dhe që është legalizuar dhe ka një VKM që ka vendosur dhe të kalojë truallin pretenduar pikërisht ankimesit Tonin Dodaj, prona e të cilit nuk është dhe nuk mund të jetë në administrim të Ministrisë së mbrojtjes, pa u zhveshur më parë nga të drejtat pronësore me një proces të rregullt ligjor.
- 4. Gjykata e Apelit nuk ka mbajtur në konsideratë kuptimin e sekuestros preventive e gjejmë të analizuar edhe në praktikën gjyqësore, veçanërisht atë të Gjykatës së Lartë, ku tërheq vëmendjen një vendim i Kolegjit Penal të kësaj gjykate, nr. 201, datë 09.12.2015 (i vendosur në tërësinë e tij edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë por i pa analizuar në raport me rrethanat konkrete).
- 5. Gjykata e Apelit ka gabuar duke mos vlerësuar se në rastin konkret ashtu si edhe rezulton nga të gjitha aktet e dosjes së gjykimit, ndaj personit të interesuar Tonin Dodaj nuk ka asnjë procedim penal të regjistruar (provohet se nuk ka emër të regjistruar për këtë shoqëria po për administratorin') apo ndonjë dyshim tjetër të arsyeshëm se ai ka kryer ndonjë veprë penale që lidhet me ndërtimin që po kryhet, apo se ky ndërtim është produkt i ndonjë veprë penale. Gjithashtu rezulton se edhe pasuria konkrete e cila është vendosur nga gjykata nën sekuestro preventive, nuk rezulton të jetë produkt i mundshëm i ndonjë veprë penale, dhe as krijon mundësi për vepra të mundshme apo shtim të pasojave të veprave penale të tjera. Është e vërtetë që prokuroria për të qenë në kushtet ligjore të vendosjes së një sekuestro preventive, me Urdhërin e saj të datës 16.03.2021, ka regjistruar procedimin penal 205/2021 të vitit për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", por pa regjistruar emër personi në hetim dhe pa specifikuar se pse kjo veprë e mundshme penale ka lidhje me pasurinë e sekuestruar, dhe pse vendosja e kësaj sekuestro preventive në rastin konkret ishte e domosdoshme

- 6. Për më tepër, edhe sikur të pranojmë në mënyrë të supozuar se do të kishim indicie apo dyshim të arsyeshëm të ekzistencës së veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal (dyshimi për kryerjen e së cilës është tejet i zbehtë për të mos thënë inekzistent, arsyetuar edhe më poshtë), sërish kryerja e kësaj vepre nuk ka një lidhje të posaçme, funksionale dhe të qëndrueshme me sendin i cili i përket personit të interesuar dhe jo personit të supozuar që do të regjistrojë prokuroria si person nën hetim.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

41. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), në radhë të parë vë në dukje faktin e ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale (në vijim KPP) me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.05.2021 (e lidhur kjo me momentin e depozitimit të rekursit nga të gjykuarit). Në nenin 38 të këtij ligji, me nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: *"1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekursi i paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre"*. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

42. Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga personat e interesuar Nik Palokaj, Saimir Mergjyli, Aida Mergjyli, Petrika Gollosi, Alqi Gollosi, Artur Palokaj, Shoqëria "Flori" shpk dhe Tonin Dodaj kundër vendimit me nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit, Shkodër, plotësojnë kriteret formale të pranueshmërisë, janë depozituar brenda afatit 45 ditor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria është njoftuar për rekursin, nëpërmjet dëftesës së komunikimit.

43. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, sipas ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të rekursit, parashikonte se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi ose për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

44. Kolegji vë në dukje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave (të shqyrtuara nga gjykatat e faktit në zbatim të nenit 152 të KPP), del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

45. Kolegji, në referim të rekursit të paraqitur nga personat e interesuar Nik Palokaj, Saimir Mergjyli, Aida Mergjyli, Petrika Gollosi, Alqi Gollosi, Artur Palokaj, Shoqëria "Flori" shpk dhe Tonin Dodaj, konstaton se Gjykata e Apelit Shkodër, në zbatim të nenit 152 të KPP, ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë. Kolegji vë në dukje se jemi përpara një mase paraprake e cila është në fazat e hetimit, dhe rezulton mëse e nevojshme për të mbajtur gjendjen aktuale që pasqyrojnë pronat de facto dhe de jure, të cilat dyshohet se janë pjesë e pronave të Forcave të Armatosura. Sigurimi i tyre me qëllim mos zhvillimin më tej apo qarkullimin e lirë civil me pasojë përfshirjen e shtetasve të tjerë në posedimin e këtyre

provave të cilat mund të rezultojnë që të jenë përfituar në mënyrë të padrejtë, e bëjnë vendimin gjyqësor të rekursuar, një vendim të drejt dhe të bazuar.

46. Në ndryshim nga sa pretendojnë personat e interesuar, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe ka trajtuar pretendimet e tyre të parashtruara në secilin rekurs. Fakti që konkluzionet e gjykatës së apelit nuk përputhen me pretendimet e rekursuesve, nuk do të thotë se vendimi i rekursuar është i paarsyetuar.

47. Kolegji thekson se Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, të cilës palët mund t'i drejtohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP. Personat e interesuar nuk kanë argumentuar nëse nga Gjykata e Apelit Shkodër është cenuar ligji penal (material ose procedural); nuk kanë evidentuar shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, sipas nenit 128 të KPP; si dhe nuk kanë parashtruar shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit apo që vendimi i rekursuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, referuar shkaqeve të rekursit të parashikuar nga neni 432 i KPP. Provat janë analizuar dhe shqyrtuar në zbatim të ligjit procedural penal (neni 152 i KPP), ku, si rrjedhojë e kësaj analize, është arritur në përfundimin se ekziston një dyshim ia arsyeshëm, për të është e nevojshme marrja e masës paraprake të sekuestros preventive mbi pronat e dyshuara si prona të Forcave të Armatosura. Prandaj, Kolegji konstaton se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të peronave të interesuar.

48. Sa më lart, Kolegji konkludon se rekursi i paraqitur nga personat e interesuar Nik Palokaj, Saimir Mergjyli, Aida Mergjyli, Petrika Gollosi, Alqi Gollosi, Artur Palokaj, Shoqëria “Flori” shpk dhe Tonin Dodaj, kundër vendimit me nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër nuk mund të pranohet, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personat e interesuar Nik Palokaj, Saimir Mergjyli, Aida Mergjyli, Petrika Gollosi, Alqi Gollosi, Artur Palokaj, Shoqëria “Flori” shpk, dhe Tonin Dodaj, kundër vendimit me nr. 111, datë 30.04.2022, të Gjykatës së Apelit, Shkodër.

Tiranë, më 07.11.2023